



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo**

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e shtatë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 31.07.2019, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, Nënkyetari për Komunitete Bajrush Ymeri, anëtarët e Kuvendit: Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Predrag Stojkovic, Zymer Zymeri, Jahi Zeqiri, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, Drejtori i Bujqësisë Sllobodan Savic, përfaqësuesi i OSBE-es, zyrtar dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshtendeti të pranishmit tha: para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë të gjithë antarët e Kuvendit dhe kemi korum për punë dhe vendimarrje, gjithashtu Kryesusi ju tha antarëve të Kuvendit që të qendrojn në mbledhje deri në fund si dhe nese e lironj mbledhjen më heret do të evidentohen dhe e filloj mbledhjen me këtë:

**Rend dite**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi i Raportit Financar të tremujorit të dytë 2019;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të jashtëm për vitin 2018;
4. Formimi i komisionit për dhenje në shfrytëzim dhe ndrrim të pronës së patundshme Komunale;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Nënkyetari për Komunitete Bajrush Ymeri pasi pershendetetë pranishmit tha: kerkoi falje që e mora fjalën tanë por unë si Nenkryetar i Komunës deshiroj ta ngris një shqetësim rreth një pikes së rendit të ditës që po sillet që 3 mbledhje të shtëtë fjalë për dhënjen në shfrytëzim të vendgjetës në Komunën e Novobërdës. Siç e dini ka qenë kjo pikë njëher në KPF, ka ardhur në Kuvendin Komunal dhe pastaj në munges të propozuesit i cili me arsyë ka qenë në udhëtim zyrtar jasht vendit të shtëtë shty për mbledhjen e radhes, pastaj kjo pikë shtëtë kthy perseri në KPF nuk është pranu që të diskutohet dhe të shkohet në Kuvend poashtu në mbledhjen e fundit që shtëtë mbajt javen e kaluar shtë stopuar në KPF dhe nuk është ardh në Kuvend dhe unë sot kerkoi që kjo pikë të futet perseri në rend dite të diskutoni dhe të jepni pelqimin për formimin e vendgjetës në Komunën e Novobërdës. Ju jeni antarë të Kuvendit Komunal, keni mar vot nga qytetarët dhe i keni pergjegjësit e juaja, inatet që i keni mban aty ku duhet mi mbajt por kur shtëtë në pyetje vendgjetia për një shoqatë të gjuetarëve që operon në teritorin e Komunës sonë shtë mirë me ja dhënë mundësin pasi që gjuetarët paguajn antarësim prej 100€ në vit dhe me ju pamundësu mos me

## Procesverbali i Kuvendit

ushtu veprimtarin në teritorin e Komunës sonë kjo nuk është e drejt andaj është mirë që sot të futet kjo pikë në rend dite dhe të shqyrtohet sepse neni 8 thot që vendgjetin e perbashkët themelohet në mbledhje Komunale pra është obligim i juaji që të themelohet si asamble Komunale, andaj ju bëjë thirrje edhe ju zt.Kryesues që ta propozoni këtë pikë ta futni në rend dite dhe ta votoni, ju faleminderit.

Kryesusi tha: konsideroj se ju si Nenkryetar nuk keni të drejt ta propozoni këtë pikë për rend dite pasi që kjo pikë i takon Drejtoris së Bujqësisë.

Drejtori i Financave Sercan Todorovic pasi pershendetë të pranishmit tha: e kam edhe unë një propozim për rend dite për bartje të mjeteve, bëhet fjal për bartjen e mjeteve të cilat kan qenë të ndara në kodit ekonomik të Drejtoris së Bujqësisë për vaksinimin e kafshëve të bartën në kodin ekonomik për pergaditjen e projekteve, kur e kemi propozuar më heret këto projekte Kuvendit për investime kapitale nuk i keni votuar dhe ne nuk kemi pasur mundësi që ti shpenzojm këto mjete për vaksionim të kafshëve. Zv.Kryesusi Ramush Mehmeti pasi pershendetë të pranishmit tha: unë nuk pajtohem me propozimin e Drejtorit për një arsy, ne e kemi ndarë një buxhet të vogel prej 20,000 € për Drejtorin e Bujqësisë dhe të thuhet se nuk i kemi shpenzuar këto mjete për subvencionimin e kafshëve pasi që është projekt për investime kapitale është e papranueshme pasi që në këtë projekt perfitojn të gjithë fermeret pa dallim etnie dhe partie. Ne e kemi ndarë një buxhet nga të hyrat vetanake një shumë prej 58,000€ për investime kapitale, dmth kemi buxhet të mjaftueshem për projekte por të mirren nga bujqësia dhe të bartën në projekte nuk pajtohem, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: mjetet për investime kapitale janë vetem për projekte kapitale dhe jo për subvencione, duhet të pajtoheni të gjithë që të ndahen këto mjete pasi që janë në interes te të gjithë qytetarëve.

Ramush Mehmeti tha: nese këtë buxhet nuk mundë ta ndajm në subvencione e shfrytëzojm në Drejtori të Bujqësisë, nese ne kemi gabuar si Kuvend atëher Drejtoria e Bujqësisë e bjen një propozim për një projekt konkret dhe ne do ta perkrahim, ju faleminderit.

Kryesusi tha: nese nuk ka diskutime kush është për propozimin e Drejtorit të Financave për bartje të mjeteve të cilat kanë qenë në kodin ekonomik të Drejtoris së Bujqësisë të bartën në kodin për projekte?. Më 7 vota për dhe 8 vota kunder nuk aprovohet ky propozim për rend dite.

Kryesusi e hudhi në votim rendin e ditës për aprovim.

Me 9 vota për 3 kunder (Xhejlane Behluli, Zymer Zymeri, Jahi Zeqiri) dhe 2 apstenim dhe 1 nuk ka votuar aprovohet rendi i ditës.

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;  
Kryesues e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pat vërejtje me 14 vota për dhe 1 nuk ka votuar aprovohet procesverbal i mbledhjes se kaluar.

**Pika e dytë :** Aprovimi i Raportit Financiar të tremujorit të dytë 2019;

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalen Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi përshendetë të pranishmit tha: materialin ekeni marrë të gjithë me kohë dhe keni pasur kohë të mjaftueshme që të shqyrtoni dhe analizoni, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti pasi pershendetë të pranishmit tha: po e falemenderoj Drejtorin pasi që po i permbahet afateve tremujore të raporteve financiare. Sa i perket raporteve më vjen mirë që po e prezantoni realitetin por për neve si antarë të Kuvendit është shqetësuese që qytetarëve të Komunës fatkeqështë edhe pse Kuvendi ja ka mar të drejten Kryetarit të ndaj buxhet për subvencione pa vendim të Kuvendit për në shpenzimet permbarimore shumë si dhe shpenzimet e Kryetarit 269.37€ nuk po e di se ku janë shpenzuar këto mjete, të njejten gje e ka bërë edhe ne zyre të Kuvendit ne vlere prej 536.29€ kjo është e papranueshme andaj kerkoj nga Drejtori që të na njoftoj se ku kanë shkuar këto mjete, e njejtë gjë ka ndodhur edhe në kod të arsimit, janë bërë shpenzime të paqartësuara. Permbaruesi privat për këtë

## Procesverbali i Kuvendit

tremujor të dytë i ka shpenzuar 17,498 € dhe shpenzimet tjera të kontraktuara që janë të pasqaruara 19.352 mundësish të na njoftoni se ku janë bërë këto shpenzime, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: mjetet që janë marr në zyre të Kuvendit janë pasi që i kemi pasur disa obligime dhe nuk kemi pasur mundësi që ti paguajm, kështu që janë marrë ato mjete që kan qenë të lira, në këtë raport janë paraqitur të gjitha mjetet e grumbulluara dhe të shpenzuara.

Ramush Mehmeti tha: unë mendoj se perderisa nuk vjen ai zotria dhe të na tregoj se ku janë shpenzuar ato mjete ne nuk duhet ta aprovojmë këtë raport financiar, ju faleminderit.

Abdyl Gashi pasi pershendetë të pranishmit tha: raportimet vazhdojn prap të jen me gabime të njejtë, shqetësuese është se Komunat vazhdon të punoj vetem për permbarues i cili vazhdon ti merr mjetet që janë të lira, shqetësim tjetër është qiraja nga objektet publike që është zero dhe mendoj se ka objekte publike që janë me qira si dhe taksat për leje ndertimi 1,181 € kjo shumë është vetem per një ose dy shtepi që kanë marrë leje ndertimi ndërsa Komuna jonë ka një teritor mjaft të madhë dhe mjaft të zgjeruar që ka mundësi me mbulu më shumë me një inspektor më të mirë dhe me grumbullu më shumë mjete. Te arsimi fillor kontratat tjetra është shuma 7,949€ kerkoi që ta dij se çka është kjo shumë?, pothuajse në secilen tabel nese e analizojm ka edhe shkelje ka edhe gabime teknike që nuk mendoj të jetë ashtu por janë gabime të qëllimshme të kësaj qeverisje Komunale që bashkarishtë qeveris edhe me subjekte tjera siç është LDK.

Sercan Todorovic tha: raporti nga qiraja është zero pasi që deri tash askush nuk ka paguar dhe kan afat deri në nentor që ti kryejn pagesat, si dhe taksat për leje ndertimi është ajo shumë që është dhe ne nuk mundëti detyrojm që të ndertojn më shumë.

Abdyl Gashi tha: nuk është arsy a kan afat apo jo, por ne çdo here raportet i kemi me të hyra, është edhe raporti i auditimit që ne e kemi lexu dhe ka vërejtje prej auditorit por është pikë që do të diskutojmë vonë.

Jahi Zeqiri pasi pershendetë të pranishmit tha: e kam një pyetje konkrete për Abdyl Gashin, a ka naj deshmi që ka pagu leje ndertimi ndonjë bashkëshatar i tij ose një koleg, shok ose antar i familjes së tij që po akuzon të LDK-ja?

Abdyl Gashi tha: besoj se kur qeveris perjegjësia ndahet e perbashkët, Kryetari e di që urdheron dhe LDK-ja e jep shembullin më të keq pasi që Drejtorat që nuk janë aktiv, qendrojn në shtepi dhe marrin pagu nga taksat e qytetarëve.

Pasi nuk pati diskutime tjetra me 6 vota për 8 kunder ( Nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic,) dhe 1 apstenim nuk aprovohet raporti financiar për tremujorin e dytë 2019.

**Pika e tretë:** Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të jashtëm për vitin 2018;

Kryesusi tha: Kuvendi e ka pranuar raportin e auditorëve të jashtëm për vitin 2018 të gjithë ju e keni marrë me material nese keni ndonjë diskutim për këtë pikë, urdhëroni.

Abdyl Gashi tha: e kam lexuar raportin me perkushtim të madhë pasi që kam dashur që ta evidentoj çdo shkelje dhe kam dashur që secili Drejtor përkatës me pas një perjegjësi para asambleistave, ka shklje marramnedese dhe njëra prej tyre është për 14 puntorë në arsim nuk është vertetuar dhe nuk është sjell deshmi për vijueshmerin në punë dhe kjo i ka kushtuar rreth 43,000€ buxhetit të Komunës dhe kjo është një shkelje shumë e rënd, po të hym në detale ka rekomandime edhe më heret që i ka dhënë auditori i jashtem por pothuajse vetem dy prej tyre janë perm bush dhe ka shkelje shumë të mëdha por do të mirrem edhe me organe tjera pasi që Drejtorat nuk janë këtu.

Selatin Nuhiu pasi pershendetë të pranishmit tha: sa i perket raportit të auditorëve kam shumë vërejtje dhe kam dhënë edhe më heret vërejtje rreth shpenzimeve të parasë publike, ne sektorin e arismit janë 43,393€ për 14 punëtor që skan gjetur deshmi për vijueshmeri në punë, nga qiraja janë 11,965€, avanset e pafitaura në vler prej 2,582€ këto avanse janë marrë dhe janë mbuluar me faktura, ndryshimi i buxhetit prej 21,000. Te klasifikimi i shpenzimeve nga kategoria e investimeve kapitale 6,329€, 4329 euro janë marrë për kafsh dhe 2,000€ janë marrë për një OJQ të Graqanices, ka vonesa në arketimin e qirasë, investimet kapitale janë realizuar vetem 74%, leje ndertimi janë lëshuar pa u perfill procedurat e parapar

## Procesverbali i Kuvendit

me ligj, ka parregullësi në fakurimin e të hyrave të tatimit në pronë, vonesat e fakturave prej 1-16 muaj, ka mjaft keqperdorime dhe raporti është shumë i keq por beseoj që këtë vit Komuna do të punoj në mënyr që ta permirësoj performancen Komunale.

Kryesuesi tha: kjo pikë ka qenë vetem shqyrtim nese nuk ka tjera diskutime kalojm në piken tjeter.

**Pika e katërt:** Formimi i komisionit për dhenje në shfrytëzim dhe ndrrim të pronës së patundshme Komunale;

Kryesusi tha: ka ardhun një kerkes nga Kryetari për formimin e këtij komision pasi që në mbledhjen e mëhershem e kemi shfuqizuar këtë komision për arsyen se ka ndryshuar ligji për dhënje të pronës Komunale në shfrytëzim, dy propozime i kemi nga ekzekutivi është Rahim Ahmeti zyrtar në Kataster dhe Sladjana Natic asistene i pres edhe dy propozime nga ju prej antarëve të Kuvendit dhe një prej shoqëris civile.

Dobrivoje Djordjevic propozoi Mirjana Simijonovic.

Ramush Mehmeti propozoi Selatin Nuhiu.

Zymer Zymeri propozoi Xhejlane Behluli.

Kryesusi e hudhi në votim propozimin e parë.

Me 14 vota për 1 nuk ka votuar Mirjana Simijonovic zgjedhet antare e komisionit për dhënje të pronës Komunale në shfrytëzim.

Me 10 vota për 2 apstenime dhe 3 nuk kan votuar zgjedhet Selatin Nuhiu antarë i komisionit për dhënje të pronës Komunale në shfrytëzim.

Me 4 vota për 5 kunder dhe 6 nuk kan votuar nuk zgjedhet Xhejlane Behluli antare për dhënje të shfrytëzim të pronës Komunale.

Kryesusi tha: a keni ndonjë propozim për antarë nga shoqëria civile?.

Mirjana Simijonovic propozoi Jovan Simic.

Dobrivoje Djordjevic propozoi Vesna Stajic.

Me 8 vota për, 2 kunder, 2 apstenime dhe 3 nuk kan votuar Jovan Simic zgjedhet antarë nga shoqëria civilenë komisionin për dhënje të pronës Komunale në shfrytëzim.

Me 1 vot për 5 kunder dhe 9 nuk kan votuar Vesna Stajic nuk zgjedhet antare në komisionin për dhënje të pronës Komunale në shfrytëzim.

Me 10 vota për 2 kunder (Xhejlane Behluli, Zymer Zymeri) 2 apstenime dhe 1 nuk ka votuar aprovohet:

### VENDIMI

**FORMOHET** Komisioni për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me këtë përbërje:

- 1.Rahim Ahmeti - Zyrtar në Kataster
- 2.Sladjana Natic - Asistente
- 3.Selatin Nuhiu - Antarë i Kuvendit
- 4.Mirjana Simijonovic - Antare e Kuvendit
- 5.Jovan Simic- Ekspert nga shoqëria civile

**Pika e pestë:** Të ndryshme.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Muharrem Tahiri nga fshati Livoq i Eperm pasi pershendetë të pranishmit tha: në fshatin Pasjak në lagjen e re është ndar një parcel që disa vite për vorreza dhe unë aty afer e kam token time dhe kam me ndrtu shtepi aty dhe kerkoj që të ndrrohet parcela për vorre pasi që aty na pengon.

Xhejlane Behluli pasi pershendetë të pranishmit tha: po më vjen shumë keq për këtë zotërin që është mundu me ardh deri ktu perderisa ka perfaqësues të atij fshati dhe ka pasur mundësin që të drejtohet edhe tek ne dhe me shqyrtu këtë qështje, sa i perket këtij problemi duhet të drejtoheni të Drejtoria për Sherbime Publike, unë jam për bashkpunim pasi që jam prej atij fshati dhe ka zgjidhje për çdo problem, ju faleminderit.

## Procesverbali i Kuvendit

Milica Jovanovic pasi pershendetë të pranishmit tha: pasi jemi të zgjedhur nga qytetarët duhet të punojmë në interes të qytetarëve dhe jam që ai vendim të anulohet.

Kryesusi tha: nuk është ky problem që lehtë shfuqizohet vendimi pasi që kjo parcel është ndar që 10 vite dhe kjo parcel egziston edhe ne hart dhe kataster që është ndar për vorreza.

Selatin Nuhiu tha: ne sapo e formuam një komision për dhënje të pronës në shfytëzim të pronës

Komunale dhe ne do ta shqyrtojmë këtë kerkes dhe do të shikojmë ndonjë mundësi tjeter për ndarje të parceles.


Bajrush Ymeri tha: pasi që ka të bëjë me një vendim kur unë kam qenë Kryetar Komune po e ndjej për obligim që ta marr fjalen, ne e kemi pasur një kerkes prej banorëve të fshatit Pasjak prej lagjes së re pasi që ata banorë ku jetojnë aty ka filluar që ajo lagje të zgjerohet dhe fhsati Pasjak i vjter i kan varrezat e veta dhe natyrisht që edhe lagija e re kanë kerkuar që ta kenë një parcel të ndarë për varreza pasi që deri atëherë të gjithë i kan varrosur në Gjilan. Duke e pasur parasysh që parcella për varreza të ndahet në një vend edhe ku kanë qasje më të lehtë dhe kerkesa e tyre konkrete ka qenë për at parcel që po thu ti sepse ka qenë tokë 20ari dhe është e ndarë edhe ne kataster por sa here që ndahet ndonjë parcel sigurisht se dikujt do ti pengoj pasi që secili ka ndonjë tokë afer. Ju me të drejt po e paraqisni kerkesen por mendoj që të formohet një komision le ta dalin në teren nese ka mundësi të bëhet ndonjë zgjedhje tjeter le të bëhet.

Muharrem Ahmeti tha: kur është ndar kjo parcel që 10 vite ne nuk kemi ditur asgje dhe toka për vorre nuk është pasi që është krej guri.

Bajrush Ymeri tha: siç tha Xhejlanja drejtohuni Drejtorisë së Sherbimeve Publike dhe Drejtoria del në teren pasi që nuk jemi për ti bërë dëmë askujt.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.  
Mbledhja përfundoi në ora 11:00.

Valmire Mustafa  
Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic  
Kryesues i Kuvendit

